

Pyetje dhe përgjigje për thirrjen e dytë të integritit social të të rinjve

“Skema e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë”

- 1. A mund të aplikojë një organizatë e re e themeluar në vitin 2019 dhe a përfshihet në vlerësim për këtë thirrje pa pasur përvojë relevante 3 vjeçare dhe fonde të mëhershme?**
 - Po, mund të aplikojnë OJQ-të e reja (themeluara kohëve të fundit). Por, keni parasysh specifikimin në thirrjen për propozime (Udhëzuesi për Aplikim) ku theksohet se *Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante* i shton 20% vlerësimin të përgjithshëm të projektit.
- 2. Organizata që përfaqësoj ka qarkullim vjetor më të lartë se €25,000 andaj do të doja të sigurohesha se a mund të aplikojmë apo jo për këto fonde.**
 - Për të pasur mundësi aplikimi, aplikanti duhet të ketë qarkullim vjetor më të ulët se €25,000 për tri vitet e fundit.
- 3. A mund të aplikojnë edhe iniciativat start-up me status sh.p.k?**
 - Jo, vetëm organizatat jo fitimprurëse mund të aplikojnë. Certifikata e regjistrimit të organizatës si OJQ është dokument obligativ për aplikim.
- 4. Qarkullimi vjetor i organizatës a konsiderohet vetëm në fundin e vitit paraprak (2018) apo merret një mesatare për tre vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018?**
 - Për të pasur mundësi aplikimi, aplikanti duhet të ketë qarkullim vjetor më të ulët se €25,000 për tri vitet e fundit (mos të kalojë €25,000 në 2016, në 2017 dhe në 2018).
- 5. A lejohet partneriteti për aplikim në këtë thirrje?**
 - Po, partneritetet inkurajohen dhe aplikantët mund të jenë udhëheqës (lead) ose partner në aplikim.
- 6. A mund të aplikojnë organizatat me më shumë se një aplikacion?**
 - Organizatat mund të aplikojnë me një aplikacion, qoftë ajo si aplikant udhëheqës (lead) ose partner.
- 7. A mund të përfitojë organizata më shumë se një grant?**
 - Jo, një organizatë mund të përfitojë vetëm një grant, qoftë ajo si aplikant udhëheqës (lead) ose partner.
- 8. Duke pasur parasysh se ne kemi përvojë në zbatimin e projekteve me të rinjtë, ne jemi të interesuar të aplikojmë me një projekt-propozim. Pyetja jonë është se a mund të aplikojmë nëse nuk kemi pasur fonde në vitin 2016?**
 - Po, mund të aplikoni por keni parasysh specifikimin në thirrjen për propozime (Udhëzuesi për Aplikim) ku theksohet se *Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante* i shton 20% vlerësimin të përgjithshëm të projektit.